

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“FACILITY & TECH SUPPORT” SHPK

Ky Statut është hartuar në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Regjistrimi i shoqërisë

Shoqëria do të regjistrohet në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë dhe do të fitojë personalitet juridik pas regjistrimit.

Ajo është themeluar nga ortakët themelues Znj.Laureta Goxhaj, Znj.Ervisa Kozari, dhe Znj.Arjola Goxhaj (“Ortakët Themelues”).

Neni 2
Emri i shoqërisë

Emri i shoqërisë është “**FACILITY & TECH SUPPORT**” Shpk, (më poshtë referuar si “Shoqëria”).

Neni 3
Zyra qendrore e Shoqërisë

3.1. Zyra qendrore e Shoqërisë do të jetë në adresën: Rruga “Gjikë Kuqali”, Godina me Nr.Pasurie 5/527, ZK.8270, Vol.60, Faqe 79, Tiranë, Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale dhe zyra përfaqësimi në çdo vend brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe do të zbatojë procedurat përkatëse ligjore dhe të regjistrimit.

Neni 4
Forma ligjore e Shoqërisë

Shoqëria është person juridik shqiptar dhe është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

L. Goxhaj

AG

E. Kozari

Neni 6 Objekti i aktivitetit të Shoqërisë

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë do jetë:

1. Marrja përsiper e projektimit dhe/ose zbatimit të punimeve të montimit të teknologjive, impianteve industriale, të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe/ose shërbimet e mirëmbajtjes së tyre. Realizimi i projektimit dhe/ose zbatimit të veprave të veçanta dhe punimeve speciale si silloza, kulla, punime themeli, vepra hidroteknike, vepra arti rrugore dhe hekurudhore, ndertime detare, rruge, porte, aeroporte etj. dhe/ose shërbimet e mirëmbajtjes së tyre. Marrja përsiper dhe realizimi i studimeve, kërkimeve dhe/ose hartimi i projekteve teknike në fusha të ndryshme në lidhje kryesisht me aktivitetet në fushën e ndërtimit, por jo vetëm. Krijimi i sipërmarrjeve industriale ose teknike në pergjithësi dhe tregtimi i produkteve të tyre brënda dhe jashtë vendit. Montimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve elektronike/elektrike industriale, pajisjeve të ndryshme dhe aparateve të cilat përdoren për qëllime të veçanta si dhe projektimi /zbatimi i çdo veprave metalike.

2. Tregtim, import-eksport i materialeve të ndryshme në fushën e ndërtimit, përfshirë lënde të para apo të perpunuara. Import-eksport, tregtimin me shumicë dhe pakicë të anikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve, ushqimore, industriale, bujqësore, blegtorale, bimë medicinale e eterovajore, kozmetikë e estetikë, konfeksione dhe tekstile etj. Tregtim me shumicë dhe pakicë të materialeve elektro-shtëpiake, elektronike, kompjuterike, higjeno-sanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanati etj. Tregtim automjeteve të çdo lloji, makineri dhe pajisje të ndryshme industriale dhe bujqësore si dhe pjesë këmbimi për automjete dhe makineri. Transport mallrash dhe/ose udhëtarësh brënda dhe jashtë vendit. Tregtimin e materialeve të ndërtimit, të lëndeve të para të ndërtimit brënda dhe jashtë vendit. Import-eksport, tregtimi me shumicë dhe pakicë i gjeneratorëve të llojeve të ndryshme. Riparimi dhe mirëmbajtja e tyre. Prodhimi dhe shitblerja e energjisë alternative. Zhvillim aktiviteti në fushën e hoteleri-turizëm, përfshirë hotel, motel, bar, restaurant, diskoteka, qendra pushimi dhe qendra kurative, agjensi turizmi etj. Kryerja e shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve (servis, pike larje makinash). Aktivitete ndërmjetësimi në formën e agjentit tretar të shoqërive vendase dhe të huaja. Për realizimin e veprimtarive të saj, shoqëria ka të drejtë të hapë njësi grumbulluese, përpunuese, shërbimi e tregtimi vetë ose duke bashkëpunuar me persona fizike ose juridike, vendas ose të huaja.



PJESA II KAPITALI I REGJISTRUAR I SHOQËRISE DHE KUOTAT

Neni 7 Kapitali

7.1 Kapitali i Shoqërisë është **100,000** (njëqind mijë) **Lekë** dhe është i ndarë në tre kuota. Kapitali është paguar tërësisht në para fizike.

7.2 Kapitali mund të zmadhohet apo zvogëlohet nëpërmjet një vendimi të Asamblesë së Ortakëve të miratuar në përputhje me këtë Statut dhe dispozitat ligjore të zbatueshme.

7.3 Kuotat zotërohen nga Ortakët si më poshtë:



Znj. Laureta Goxhaj, shtetase shqiptare, lindur më 23.08.1973, në Fier, Shqipëri, mbajtëse e Letërnjoftimit Elektronik me Nr.033818020, Nr.Personal H35823124J, zotëruese e **34% (tridhjetë e katër përqind)** të kapitalit të paguar.

Znj. Ervisa Kozari, shtetase shqiptare lindur më 24.03.1989, në Korçë, Shqipëri, mbajtëse e Letërnjoftimit Elektronik me Nr.035969413, Nr.Personal I95324070V, zotëruese e **33% (tridhjetë e tre përqind)** të kapitalit të paguar.

Znj. Arjola Goxhaj, shtetase shqiptare, lindur më 01.08.1979, në Elbasan, Shqipëri, mbajtëse e Letërnjoftimit Elektronik me Nr.036069122, Nr.Personal H958010760, zotëruese e **33% (tridhjetë e tre përqind)** të kapitalit të paguar

PJESA III TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

Neni 8 Përgjegjësia e kufizuar

Ortakët do të jenë përgjegjës deri në vlerën e papaguar të kontributit të kuotës së tij në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha aktivet.

Neni 9 Të drejtat e lidhura me çdo kuotë

Kuota e secilit ortak do t'i përgjigjet një vote në Asamblëtë e Ortakëve dhe do t'i japë ortakëve të drejtën për të marrë dividendë në rast shpërndarje të fitimit si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të Shoqërisë.

Neni 10 E drejta e pjesëmarrjes në mbledhjet e Asamblesë

10.1 Ortakët kanë të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrjen e Shoqërisë në Asamblenë e Ortakëve të Shoqërisë.

10.2 Secili ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblenë e Ortakëve personalisht ose me prokurë. Ortakët do të lejohen të marrin pjesë në çdo Asamble të Ortakëve me telefon ose video konferencë si dhe do të lejohen gjithashtu të votojnë me faks apo e-mail (apo çdo mjet tjetër komunikimi) apo të japin prokurë për qëllim votimi çdo personi sipas zgjedhjes së tyre (i cili nuk duhet të jetë Ortak), dhe në një rast të tillë, Ortaku përkatës do të konsiderohet prezent ose i përfaqësuar. Përveç sa më sipër, çdo vendim i Asamblesë së Ortakëve do të merret me shkrim.

Goxhaj

AG

Kozari

Neni 11
E drejta për të inspektuar dokumentet e Shoqërisë

Secili Ortak do të ketë të drejtën të informohet për çështjet e Shoqërisë si dhe të inspektojë dhe kontrollojë dokumentet dhe regjistrat e Shoqërisë përfshirë të dhënat financiare, të dhënat e çmimit, listën e furnitorëve, kontratat dhe çdo dokument tjetër.

Neni 12
Detyrimet e Ortakëve

Ortakët kanë detyrim të paguajnë pjesën e tyre në rastet e zmadhimit të kapitalit, të marrin pjesë në Asambleshë të Ortakëve nëse ftohen në mënyrën e duhur, të mbështesin Shoqërinë në kryerjen e veprimeve të saj si dhe të zbatojnë vendimet e Asamblesës së Ortakëve dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur brenda kompetencave të organit përkatës.

PJESA IV
ASAMBLEJA ORTAKËVE

Neni 13
Të drejtat e asamblesës së ortakëve

13.1 Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.

13.2 Vetëm Asambleja e Ortakëve ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:

- (a) ndryshime dhe modifikime të këtij Statuti;
- (b) për përjashtimin e një ortaku në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore;
- (c) të japë të drejta nënshkrimi dhe/ose mundësi zëvendësimi për kuotat në shoqëri.
- (d) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar dhe/ose çdo lloj pagimi të pjesëmarrësve ose subvencionit të dhënë nga ortakët;
- (e) bashkimin, ndarjen, prishjen dhe çdo lloj transformimi të Shoqërisë;
- (f) blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
- (g) hapjen dhe mbylljen e degëve dhe përfaqësive jashtë Shqipërisë;
- (h) miratimin e raporteve vjetorë dhe bilancit të shoqërive si dhe shpërndarjen e fitimit;
- (i) blerjen, shitjen dhe hipotekimin e pasurive të paluajtshme;
- (j) marrjen me qira, dhënien me qira ose dhënien e çdo të drejte për përdorimin e pasurive të paluajtshme;
- (k) të vendosë për investimet;
- (l) të vendosë për destinimin e fitimeve (shpërndajë, kapitalizojë, transferojë në rezervë)
- (m) të japë letra me vlerë, të lëshojë garanci ose letra sigurie;
- (n) të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të shoqërisë;
- (o) të caktojë shpërblimet për administratorin/ët, të lidhë kontratat e punës/manaxheriale me administratorët dhe nëpunësit ekzekutivë të Shoqërisë.
- (p) caktimin e auditorëve, ekspertëve kontabël dhe likuiduesve;

Soxhoji,

AG

Alban

- (q) miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin;
- (r) ngritjen e padive kundër administratorit të Shoqërisë apo Ortakëve;
- (s) përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;
- (t) përcaktimin e buxhetit vjetor;
- (u) miratimin e çdo çështje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar Asamblesë së Ortakëve në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.

13.3 Në çdo rast Asambleja e Ortakëve do të ketë të drejtë të vendosë mbi çdo çështje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme që lidhet me aktivitetin e Shoqërisë.

Neni 14

Vendimet e asamblesë së ortakëve

14.1 Çështjet, veprimet apo vendimet e mëposhtme në lidhje me Shoqërinë do të kërkojnë miratimin me 3/4 e votave të Ortakëve pjesëmarrës:

- a) miratimin e destinimit të fitimit dhe shpërndarjes së dividendit;
- b) modifikimet apo ndryshimet e Statuti dhe dokumenteve të tjerë organizativ të Shoqërisë
- c) lëshimi i kuotave të tjera apo dokumenteve të borxhit të konvertueshëm të cilat mund ti japin mbajtësit të tyre të drejtën të marrë, përfitojë apo nënshkruajë kuota të Shoqërisë, ndryshimin e strukturës së kapitalit të Shoqërisë;
- d) zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit;
- e) çdo dhënie të drejtë Administratorit për të zmadhuar kapitalin nëpërmjet kapitalit të autorizuar;
- f) bashkimin apo ndarjen, likuidimin, prishjen dhe ose mbylljen, transformimin e Shoqërisë
- g) blerja/nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve kryesore/ dhe vënia e barrëve sigurisë mbi aktivet e një Shoqërie;
- h) marrja e kredive, huave dhe angazhimi për ndonjë borxh;
- i) lidhjen e ndonjë kontrate, transaksioni ose marrëveshje ndërmjet Shoqërisë dhe çdo Ortaku ose një Filiali të një Ortaku ose Drejtori;

14.2 Vendimet për të gjithë çështjet e tjera të cilat nuk janë listuar më sipër do të merren me shumicë të thjeshtë të Ortakëve pjesëmarrës.

14.3 Në Asamblenë e Ortakëve votimi është i hapur. Në raste të veçanta dhe për çështje të veçanta, një vendim mund të merret me votim të fshehtë në përputhje me dispozitat ligjore.

Neni 15

Thirrja e asamblesë së ortakëve

15.1 Asambleja e Ortakëve do të thirret nga administratorët të paktën njëherë në vit në zyrën qendrore të Shoqërisë ose në çdo vend tjetër nëse përcaktohet në njoftim.

15.2 Gjithashtu, ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblenë e Ortakëve mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim ose nëpërmjet postës

elektronike për të thirrur Asamblenë e Ortakëve. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet për të cilat duhet të vendosë Asambleja e Ortakëve.

15.3 Asambleja e ortakëve do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga administratori, njoftim ky i cili duhet të merret nga përfaqësuesit e ortakëve nëpërmjet një letre rekomande apo faksi jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes. Ftesa e shkruar do të regjistrohet në regjistrin e Asamblesë së Ortakëve. Gjithashtu, Asambleja e Ortakëve mund të thirret nëpërmjet postës ose postës elektronike me të njëjtat kushte dhe afate, në adresat e përcaktuara prej tyre e dhënë administratorit:

15.4 Ftesa për takimin e Asamblesë së Ortakëve do të tregojë datën kohën dhe vendin e takim si dhe çështjet e rendit të ditës dhe, në rastin e një asambleje të zakonshme të ortakëve do të përfshijë gjithashtu dhe pasqyrat financiare dhe raportin e administrimit.

15.5 Nëse data për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë së Ortakëve është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qenë prezentë, atëherë do të gjykohet sikur njoftimi është dërguar.

15.6 Nëse të gjithë ortakët janë prezentë në Asamblenë e Ortakëve, atëherë Asambleja e Ortakëve mund të zhvillohet dhe vendimet mund të merren edhe në mungesë të përmbushjes së kërkesave formale të cituara më sipër nëse të gjithë ortakët janë dakord.

Neni 16

Vendimet e marra në asamblenë e ortakëve

16.1 Vendimet në Asamblenë e Ortakëve të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Vendimet në Asamblesë e Ortakëve për rastet e çështjeve sipas nenit 14.1 më sipër mund të merren dhe do të jenë të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë në votim ortakët që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave me të drejtë vote.

16.2 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Ortakëve.

16.3 Secili ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e ortakëve, të cilat do të jenë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.

16.4 Nëse Asambleja e Ortakëve thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përmbushur kuorumin, atëherë asambleja do të thirret përsëri në përputhje me Nenin 15 dhe gjithmonë jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite. Mbledhja e dytë e ortakëve ka të drejtë të marrë vendime mbi çështjet e caktuara në rendin e ditës pavarësisht nga kuorumi (numri i kuotave të përfaqësuar).

Neni 17

Drejtimi i mbledhjes se ortakeve

17.1 Kryetari i Asamblesë së Ortakëve do të caktohet nga ortakët.

17.2 Do të miratohen apo refuzohen vetëm ato çështje të cilat janë përcaktuar shprehimisht në ftesën (rendin e ditës) për Asamblesë e Ortakëve. Diskutimet mbi çështje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse të gjithë ortakët japin pëlqimin e tyre.

Neni 18 **Procesverbali i Asamblesë së Ortakëve**

18.1 Për çdo zhvillim të Asamblesë së Ortakëve dhe vendimet që do të merren në Asamble do të mbahet një procesverbal. Procesverbali duhet të mbajë datën, vendin, rendin e ditës, emrin e mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin tregtar dhe një për secilin Ortak. Procesverbalit i bashkëngjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së Asamblesë.

18.2 Procesverbali do të firmoset nga kryetari dhe kundër-firmoset nga sekretari që e mban atë. Procesverbali për vendimmarrje të Çështjeve të Rezervuara do të firmoset gjithashtu nga të gjithë Ortakët.

18.3 Kopjet e vendimeve përkatëse të Asamblesë së Ortakëve do t'u dërgohen ortakëve me letër rekomande jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas Asamblesë së Ortakëve.

18.4 Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesverbalit dhe shpërndarjen e tij.

PJESA V **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Neni 19 **Administrimi i Shoqërisë**

19.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një administrator, i cili do e përfaqësojë Shoqërinë për një afat prej dy (2) vjetësh me mundësi rizgjedhje, për një periudhë të njëjtë apo më të shkurtër. Sidoqoftë, Asambleja e Ortakëve mund të vendosë që administrimi i shoqërisë mund të bëhet nga 2 ose më shumë administratorë.


19.2 Administratori mund të autorizojë palë të treta që ta përfaqësojnë atë në transaksione të veçanta.

19.3 Administratori do të organizojë dhe menaxhojë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ai është i autorizuar të përfaqësojë Shoqërinë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me të.

19.4 Të drejtat dhe detyrimet e administratorit burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e ortakëve dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.

19.5 Duke marrë parasysh kufizimet e Nenit 13 më sipër, administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

(a) përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;



- (b) hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
- (c) lidhjen e marrëveshjeve me palët e treta me vlerë deri në 1,000 Euro ose ekuivalentin në lekë apo monedha të tjera. Cdo marrëveshje apo kontrate që përfshin shuma të larta do të nënshkruhet pas marrjes së miratimit të asamblesë së ortakëve;
- (d) lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave, transferimet në monedhë të huaj, kryerjen e pagesave përfshirë këtu edhe paradhëniet, deri në shumën prej **50,000 Lekë ose ekuivalentin në monedha te tjera, në muaj**. Për kryerjen e veprimeve si më sipër për shuma më të mëdha administratori do të veprojë së bashku me **Znj. Laureta Goxhaj**;
- (e) nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, lëshimin e faturave, fletë ngarkesat etj., pagimin e detyrimeve të Shoqërisë pas miratimit të asamblesë së ortakëve në rastet e kufizimeve sipas pikave (c) dhe (d) dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
- (f) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhe marrjen e paradhënieve;
- (g) dhënien e moratoriumit debitorëve të Shoqërisë, dhe me miratimin e asamblesë së ortakëve, heqjen dorë nga paditë që vijnë si pasojë e marrëdhënieve të Shoqërisë me palët e treta dhe/ose pranimin e heqjes dorë;
- (h) punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë dhe bazuar në vendimin e asamblesë së ortakëve përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
- (i) marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratori mund të udhëzojë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe me miratimin e ortakëve të nënshkruajë marrëveshjet dhe mund të përcaktojë shumën e shpërblimit të tyre; administratori ka të drejtë që bazuar në miratimin e vendimit të asamblesë së ortakëve të depozitojë ankesa dhe t'i tërheqë ato, të nënshkruajë marrëveshje gjyqësore, të lidhë marrëveshje arbitrazhi, të caktoj arbitra, të tërheqë paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërpresë procedimet;
- (j) të marrë çdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- (k) të kontrollojë shpenzimet e Shoqërisë;
- (l) mbajtjen e regjistrave në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit;
- (m) përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditues i jashtëm nëse diçka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i Asamblesë së Ortakëve;
- (n) thirrjen e Asamblesë së ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e Asamblesë së Ortakëve për shpalljen e vendimeve përkatëse;
- (o) publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
- (p) mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
- (q) marre vendime mbi të gjitha çështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të jashtme.

19.6 Administratori duhet të marrë aprovimin paraprak me shkrim nga Asambleja e Ortakëve përpara se të kryej ndonjë prej transaksioneve dhe detyrave të listuar më sipër.

Goxhaj

[Signature]

[Signature]

Neni 20
Shkarkimi dhe dorëheqja e Administratorit

20.1 Asambleja e Ortakëve mund të shkarkojë administratorin e Shoqërisë në çdo kohë me shumicë të thjeshtë.

20.2 Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Asamblesë së Ortakëve. Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Ortakëve për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi. Nëse Asambleja e Ortakëve nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administrator i dorëhequr, atëherë administrator do të njoftojë autoritetet kompetente me shkrim, së bashku me një koje të procesverbalit të Asamblesë së Ortakëve. Autoritetet kompetente do të regjistrojnë shkarkimin e administratorit në përputhje me procedurat e brendshme.

PJESA VI
TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 21
E drejta e parablerjes

Secili ortak ka të drejtë të transferojë në përputhje me ligjin dhe këtë Statut, kuotën e tij tek një person tjetër duke patur parasysh kushtin se ortaku tjetër ka të drejtën e parablerjes. Ortaku i cili ka si qëllim të transferojë kuotën e tij duhet t'ia ofrojë atë njëherë ortakut tjetër. Nëse ky i fundit nuk bie dakord apo nuk përgjigjet me shkrim në lidhje me këtë ofertë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ofertës, atëherë ortaku mund ta transferojë lirisht kuotën e tij te persona të tretë jashtë Shoqërisë. Çdo transferim i kryer në kundërshtim me këtë nen është i pavlefshëm.

PJESA VII
VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET

Neni 22
Viti financiar, pasqyrat vjetore financiare

22.1 Viti financiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit.

22.2 Në fund të çdo viti financiar, administratori do të përmbushë detyrat e mëposhtme:

- (a) përgatitjen e një liste të detajuar të aktiveve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;
- (b) përgatitjen e bilancit të shoqërisë i cili përshkruan situatën e biznesit të Shoqërisë;
- (c) përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.

22.3 Pasqyrat financiare të përgatitura në këtë mënyrë do të paraqiten në Asamblenë e Ortakëve së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm (në rastin kur kërkohet) për miratim.

Loxhaji

[Signature]

[Signature]

Neni 23
Fitimi i Shoqërisë

23.1 Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahet sipas pjesëmarrjes të secilit ortak në kapitalin e shoqërisë.

23.2 Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha tatimeve dhe caktimit të rezervave ligjore nëse do të konsiderohet e nevojshme nga Asambleja e Ortakëve. Bilanci i shoqërisë do të miratohet nga Asambleja e Ortakëve dhe do të dorëzohet në organet tatimore dhe organet e tjera brenda afateve ligjore.

PJESA VIII
PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Neni 24
Prishja dhe likuidimi

24.1. Shoqëria do të priset në rastet e mëposhtme:

- (a) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- (b) nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër;
- (c) mbi bazën e një vendimi të gjykatës kompetente në rastet e parashikuara nga ligji;
- (d) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji.
- (e) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së aktiveve për të mbuluar kostot e procedurës së falimentimit
- (f) në rast se objekti bëhet i pamundur për shkak të keqfunksionimit të organeve të shoqërisë ose për çdo arsye tjetër që e bën absolutisht të pamundur vazhdimin e aktivitetit.

24.2 Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e aktiveve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.

PJESA IX
TË PËRGJITHSHME

Neni 25
Të përgjithshme

25.1 Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përpiqen fillimisht t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata kompetente.

25.2 Ligji shqiptar do të zbatohet.

25.3 Ky Statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Loxhøj 11

[Signature]

[Signature]

Nënshkruar më 17 Mars 2021.

ORTAKËT

Znj. Laureta Goxhaj

Laureta Goxhaj
Goxhaj

Znj. Ervisa Kozari

Ervisa Kozari
E. Kozari

Znj. Arjola Goxhaj

Arjola Goxhaj
Goxhaj